



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2023 – Numri: 72

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 4 maj 2023

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 28.4.2023	Për një shtesë fondi në programin “Mbështetje për partitë politike”, për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore të vitit 2023..... 8399
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 22.2.2023	Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2023..... 8399
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 7.3.2023	Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik shqiptar, tarifat dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave të krijuara nga këto shërbime..... 8438
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 12, datë 28.4.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 8448
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 227, datë 13.4.2023	Për kufijtë e tolerancës..... 8448
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 230, datë 13.4.2023	Për disa shtesa në urdhrin nr. 149, datë 31.3.2022, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, ‘Për peshkimin’”..... 8451
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 4.4.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1353 (253), datë 20.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 8455
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7630, datë 26.4.2023	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 8460

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 27.3.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i lundruer i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës.....	8460
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 27.3.2023	Mbi kërkesën e OST sh.a, për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare.....	8461
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 27.3.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Tplani HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw.....	8462
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 27.3.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”, të ndryshuar.....	8464
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 27.3.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	8465
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 27.3.2023	Mbi miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a.....	8466
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 7.4.2023	Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023” .....	8468
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 7.4.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-i Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	8469
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 7.4.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-i Tirana” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8470
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 7.4.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) e aseteve fikse të centralit fotovoltaik Blue 1 në favor të <i>Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., Sicav-Sif</i> .....	8470
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 11.4.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	8471
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 311, datë 30.11.2022, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 22.12.2022.....	8473

**VENDIM**

Nr. 269, datë 28.4.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
PROGRAMIN “MBËSHËTJETE PËR  
PARTITË POLITIKE”, PËR  
FINANCIMIN E FUSHATËS  
ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE  
PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E VETËQEVERISJES  
VENDORE TË VITIT 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 88, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të vendimit nr. 30/2023, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Për financimin e fushatës zgjedhore për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në programin “Mbështetje për partitë politike” shtohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, i cili u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në këto zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

2. Efekti financiar, i parashikuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**UDHËZIM**

Nr. 5, datë 22.2.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE  
TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË  
AUTORITETIN PORTUAL DURRËS  
PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës, nenit 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 1, nenit 38, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”, me propozim të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr. 16, datë 19.12.2022, të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, zëvendëskryeministri dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

**UDHËZOJNË:**

1. Tarifat për shërbimet portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2023, caktohen sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës është shprehur pa TVSH.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi do të aplikohen tarifat e reja edhe për kontratat e lidhura më përpara me subjektet.

3. Institucioni përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe për vjeljen e tarifave është Autoriteti Portual Durrës ose subjekte të autorizuara prej tij.

4. Udhëzimi nr. 4, datë 11.6.2021, “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës, për vitin 2021”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 60 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Belinda Balluku**

**MINISTËR I FINANCËS  
DHE EKONOMISË  
Delina Ibrahimaj**



DURRËS ALBANIA

2023

## TARIFAT

## PORTI I DURRËSIT

## REFERENCA LIGJORE

## KAPITULLI 1

## TARIFAT E PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES

## 1. TARIFAT E PORTIT DHE TË KANALIT

## 1.1 Përkufizime

## 1.1.1 Tarifat e portit dhe të kanalit

## 1.2 TARIFAT E AKOSTIMIT

## 1.2.1 Përkufizime

## 1.2.2 Tarifat e kalatës/vendakostimit

## KAPITULLI 2

## TARIFAT E PËRPUNIMIT TË PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES, APO I MALLIT

## 2. TARIFAT E PËRPUNIMIT TË ANIJEVE ME MALLRA

## 2.1 Përkufizime

## 2.2 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave rifuxho

## 2.3 Tarifat për përpunimin e mallrave të rënda rifuxho

## 2.4 Tarifat për përpunimin e mallrave të lehta rifuxho

## 2.5 Tarifat për përpunimin e mallrave të lëngshme

## 2.6 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave gjenerale

## 2.7 Tarifave për përpunimin e mallrave gjenerale

## 2.8 Përkufizime të tjera për imbarkimin / disimbarkimin e pasagjerëve

## 2.9 Tarifat e imbarkimit/disimbarkimit të pasagjerëve me tragete

2.10 Përkufizime të tjera për përpunimin *Roll-on/Roll-off* të ngarkesave2.11 Tarifat e përpunimit të automjeteve dhe makinave (Mallra *Ro/Ro*)

## 2.12 Përkufizime të tjera për përpunimin e kontejnerëve

## 2.13 Tarifat për përpunimin e kontejnerëve

## 2.14 Tarifa për raste të veçanta

## KAPITULLI 3

## TARIFAT E SHESHIT PRANË KALATËS DHE TË TRANSFERIMIT TË PAGUESHME NGA PRITËSI I MALLIT OSE SPEDICIONI

3. TARIFA *WHARFAGE* DHE TRANSFERIMIT

## 3.1 Përkufizime

3.2 Tarifat *Wharfage*

## 3.3 Tarifat e transferimit

## KAPITULLI 4

## MAGAZINIM, QIRAJA DHE TARIFAT E QIRADHËNIES

## 4. TARIFAT E MAGAZINIMIT TË NGARKESAVE DHE KONTEJNERËVE

## 4.1 Përkufizime

## 4.2 Tarifat për magazinimin e kontejnerëve

## 4.3 Tarifat për magazinimin e ngarkesave

## TARIFAT E DHËNIES ME QIRA

## 4.4 Tarifat për dhënien me qira të shesheve

## 4.5 Tarifat për dhënien me qira të shesheve tranzitore

## 4.6 Tarifat përdorimin të sillosave

## 4.7 Tarifat e dhënies me qira afatgjatë të shesheve

## 4.8 Tarifat për qiratë për ambiente të tjera të Portit

## 4.9 Tarifat për qiradhënie të mjeteve

## 4.10 Tarifat për reklamat

## KAPITULLI 5

## TARIFA TË TJERA

## 5. TARIFA TË TJERA

## 5.1 Tarifat për certifikatën e deratizimit

## 5.2 Tarifa për certifikatën mjekësore të anijes

## 5.3 Tarifa e shërbimit për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit

## 5.5 Tarifat e parkingut

## 5.6 Tarifat e personave dhe mjeteve që hyjnë në port

## 5.7 Komisioni për mbledhjen e të ardhurave

## 5.8 Tarifë preferenciale për eksportin e sasive të mëdha të mineralit të hekurit

## KAPITULLI 6

## TARIFA TË APLIKUESHME PËR SHËRBIME JASHTË TERMINALEVE

## 6.1 Akostimit deri dhe përfshirë 500 GT (jo mjetet e shërbimeve si pilotë, rimorkiatorë etj.)

## 6.2 Qira sheshi për zyre mobile. \*Përdoret dhe për parkimin në tokë të mjeteve lundruese, turistike, si skaf, jahte etj.



- 6.2.1 Qira sheshi gjeneral afatgjatë
- 6.2.2 Qira sheshi për operatorët kontraktual
- 6.2.3 Qira ambienti për operator kontraktual
- 6.2.4 Qira për sheshe në përdorim magazinim mallrash gjeneral deri në 180 ditë
- 6.2.5 Ambient për zyra dhe shërbime
- 6.3 Tarifat për reklamat
- 6.4 Tarifa e parkimit për automjetet jashtë zonave operacionale
- 4.1 Tarifa e mjeteve që parkojnë në vend parkimet e autorizuar
- 6.5 Tarifa për qira antenash operator telefonisë mobile
- 6.6 Tarifë për pastrimin e ambienteve të përbashkëta për subjekt

#### REFERENCA LIGJORE

“Tarifat e Portit të Durrësit” janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual Durrës”, kapitulli IV, neni 35 e në vijim dhe VKM-në nr. 596, datë 10.9.2004, “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”.

#### 1. Përcaktimi i tarifave portuale

Autoriteti portual cakton tarifat, për:

Anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin.

Ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit dhe magazinimin në port.

Shërbimet që sigurohen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar, ose një e drejtë e dhënë prej tij në lidhje me portin.

Autoriteti Portual Durrës cakton normën e interesit për pagesat e vonuara.

Përkufizimet e termave jepen, si më poshtë:

i. “Arkëtimet” janë tarifat e portit dhe të ankorimit në skelë, si dhe arkëtimet e tjera që zbatohen ndaj personave dhe zotëruesve të anijeve, të ngarkesave dhe mjeteve të transportit.

ii. “Pagesa të arkëtuara nga Autoriteti Portual” janë të gjitha pagesat e kryera nga operatorë ose agjente të ndryshëm të mbledhura nga Autoriteti Portuale.

iii. “Tarifa ndaj anijes” është çdo pagesë e kërkuar nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të anijes ose agjentit të tij.

iv. “Tarifa ndaj mallit” është çdo tarifë e vendosur nga Autoriteti Portual ose nga një operator licencuar ndaj zotëruesit të mallit ose agjencive të tyre.

v. “Mallrat” janë të gjitha të mirat materiale që përdoren për veprimtarinë tregtare përveç anijes.

#### 2. Përgjegjësia për pagesat e tarifave

Tarifat dhe interesat për anijet dhe ngarkesat paguhen nga zotëruesi ose personi që ka në ngarkim anijen ose mallin dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

Tarifat dhe interesi për mjetet e transportit paguhen nga zotëruesi i mjetit dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

#### 3. Garancia e Pagesës:

1. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar ka të drejtën të mbajë anijen ose të ardhurat nga shitja e saj si garanci për shumën që anija detyrohet dhe konkretisht kjo shumë ka lidhje me:

a) Tarifat dhe interesin që duhet të shlyejë anija për qëndrimin e saj ose për mallrat e ngarkuara në të;

b) Dëmtimin e pronës nga anija ose ekuipazhi i saj.

2. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar mund të marrë si garanci mallra për shumën që i duhet të paguaje anija për tarifat dhe interesin.

3. Kur mallrat e mbajtura për garanci janë mallra që prishen, Autoriteti Portual mund t'i shesë me çmim të arsyeshëm dhe të ardhurat kreditohen për të shlyer pagesën që duhet të paguhet për anijen dhe mallrat.

#### 3. Paanësia

Kur cakton tarifat Autoriteti Portual ose operatori i autorizuar nuk i lejohet të shkelin barazinë e subjekteve përdoruese. Nuk përbën diskriminim nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave a të sasisë së të mirave që tregtohen apo mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme për një person të licencuar që ka të drejtën e caktimit të tarifave.

Çdo person i interesuar ka të drejtën e ankimit pranë drejtorit ekzekutiv kur mendon se janë bërë dallime në vendosjen e tarifave portuale.

#### 4. Miratimi i tarifave portuale

Tarifat portuale miratohen nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual, në përputhje nenin 15 të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”.



Miratimi i tarifave portuale bëhet në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm kalendarik.

Tarifat portuale të miratuara nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual, propozohen për miratim sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve dhe Ministrisë së Financave.

### 5. Hyrja ne fuqi

Hyrja në fuqi e tarifave portuale përcaktohet në udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit “Për miratimin e tarifave portuale në APD për vitin 2017”.

### 6. Informimi

Tarifat portuale janë publike dhe përdoruesit e portit duhet të jenë gjithmonë të informuar për vendosjen e tarifave të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese.

Informimi përfshin publikimin në gazetë ose Fletoren Zyrtare, si dhe publikimin në faqen e internetit të APD-së.

## KAPITULLI 1

### TARIFAT E PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES

#### 1. TARIFAT E PORTIT DHE TË KANALIT

##### 1.1 Përkufizime

##### 1. Interpretim

a) “Tarifa e portit dhe e kanalit” do të thotë një tarifë për një anije, e cila përdor kanalit e lundrimit dhe basenin e portit në portin e Durrësit;

b) “pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira (*Charter*) ose zotëuesi i anijes;

c) “port” do të thotë porti Durrësit i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual;

d) “Traget” do të thotë anije vetëm për pasagjerë dhe automjete;

e) “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

##### 2. Aplikime

a) Këto tarifa aplikohen për ato anije të cilat vijnë në ose përdorin Portin e Durrësit;

b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

### 3. Tarifat

Tarifat e Portit dhe të Kanalit duhet të llogariten sipas njësive/që janë vendosur në tabelën e mëposhtme:

a) Detyrimet për Portin dhe Kanalit të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari ose agjenti i anijes në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës, dhe mbliidhen nga Autoritetit Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij.

b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i Tarifës së Portit dhe të kanalit, janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

### 4. Përmasat e anijes

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara në certifikatën e madhësisë së tonazhit, atëherë tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b) Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasa të regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

### 5. Përfshirje

1. Tarifat e Portit dhe kanalit nuk janë të pagueshme, në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;

d) një anije që hyn në portin e Durrësit, për qëllim vendstrehimi në rast të një stuhie apo aksidenti;

e) një anije e përfshirë nga aplikimi i tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

f) anijet *yabte*, veliera etj., të kësaj natyre\*

g) anijet me flamur shqiptar që kanë mbaruar procesin e ngarkim-shkarkimit dhe nisen nga kalatat e portit kur kërkohet nga organet ligjzbatuese, pasi kanë qëndruar në radë në pritje për nisje.



2. Përjashtime në rastet “*Double banking*”:

a) për rastet e ngarkim/shkarkimit të anijeve me tonazh të madh, ku procesi nuk mund të kryhet i plotë në kalatat e Portit dhe do të realizohet nëpërmjet operacioneve, *double banking* “në Radën e Portit të Durrësit;

i) tarifa e portit dhe e kanalit dhe do të aplikohet vetëm një herë për secilën Anije për të gjithë procesin.

### 1.1.1 Tarifat e Portit dhe Kanalit

1.Tarifat e Portit dhe Kanalit për Anije për prekje	Njësia Bazë	Tarifa (€)
a Për Tragete deri në 13,000 Gt (T 1)	€/GT	0.16
Për Tragete mbi 13,000 Gt		
për çdo Gt mbi 13,000 Gt (T 2) *	€/GT	0.01
b Tarifë për çdo prekje trageti, mbi 20 prekje në muaj, për çdo kompani, për 1(një) linjë operimi *		20% zbritje
Përjashtohen nga aplikimi i kësaj tarife (b) Periudha e pikut ,15 Korrik deri në 15 Shtator dhe 15 Dhjetor deri më 15 Janar.		
Për efekt të aplikimit të pikës “b”, “muaj” do të konsiderohet periudha nga data 15 e muajit deri 15 të muajit pasardhës.		
c Për anije të tjera përfshirë dhe Anije Ro/Ro*	€/GT	0.24

## 1.2 Tarifat e Akostimit

### 1.2.1 Përkufizime

#### 1 Interpretim

- "Tarifë vendakostimi/kalate" do të thotë tarifë për një anije dhe ose traget e cila, futet brenda dhe përdor ndonjë Kalatë (vendakostim) në portin e Durrësit;
- "Pronar" do të thotë agjenti, marrësi me qera ose zotëruesi i anijes;
- "Port" do të thotë Porti Durrësit i organizuar sipas Ligjit të Autoritetit Portual;



- d "Çertifikata e madhësisë së tonazhit" do të thotë një çertifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e rregjistruar bruto (GT) ose/dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

## 2 Aplikime

- a Këto tarifa aplikohen për ato anije të cilat vijjnë në / ose përdorin Portin e Durrësit.
- b Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

## 3 Tarifat e kalatës/vendakostimit

- a Tarifat e kalatës/vendakostimit do të llogariten bazuar në tabelën e mëposhtme.;
- b Tarifat e kalatës/vendakostimit, të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari apo agjenti i anijes, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës, dhe mbliidhen nga Autoriteti Portual Durres ose përfaqësuesit e tij.
- c Detyrimet që lindin nga aplikimi i Tarifës së kalatës/ vendakostimit janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

## 4 Përmasat e Anijes

- a Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të rregjistruara, në çertifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.
- b Në qofte se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një çertifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij, mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasat e rregjistruara, për efekt të kësaj tarife.

## 5 Përjashtime

Tarifat e kalatës/vendakostimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

- a Një Luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;
- b Një anije që i përket Qeverisë Shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;





- c Një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregojnë peshkun;
- d Një anije e përjashtuar nga aplikimi i këtyre tarifave, si rezultat i ndonjë marreveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.
- g Anijet me flamur shqiptar që hyjnë në portin e Durrësit në kohë të keqe me urdhër të Kapitenerisë, të përjashtohen nga tarifa e akostimit përgjatë gjithë kohës së fortunalit. Me njoftimin nga dipeçeria qendrore e portit të Durrësit drejtuar kapitenerisë për lirim të kalatës për arsye përpunimi, anijet me flamur shqiptar duhet të lirojnë kalatën brenda një afati jo më shumë se 4 (katër) orë.

#### 1.2.2 Tarifat e kalatës/vendakostimit

1 Tarifat e kalatës/vendakostimit për anijet, janë të llogaritura bazuar në përmasat e anijes (gjatësia ose gjerësia e përgjithshme sipas akostimit) si dhe kohës së qëndrimit:	Njësia Bazë	Tarif (€)
a Anije Konteinerë	€/meter linear të Anijes për ditë ose pjesë të saj	4.60
b Çisterna (kimikate/ lëngje rinfuze)	€/metër linear të anijes për ditë pjesë të saj.	4.01
c Tragete, Kroçera, Anije Ro/Ro dhe pasagjerësh	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.65
d Anije transporti mallrash rifuxho	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.96
e Anije transporti mallrash gjenerale	€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.96



2 Tarifat për anijet me flamur shqiptar të cilat kanë mbaruar proceset e ngarkim shkarkimit të mallrave.	Njësia bazë	Tarifa (€)
Për anije që qëndrojnë në port jo për veprime tregtare	€/metër linear në ditë ose pjesë të sajë	1.32
Për anije që qëndrojnë në port në kohë të keqe	€/metër linear në ditë ose pjesë të sajë	0.00
Për anije që qëndrojnë në port pas kohës së keqe (njoftimi i dispeçerisë 4 ore)	€/metër linear në ditë ose pjesë të sajë	1.32
Për anije që qëndrojnë në port pas kohës së keqe (4 ore pas njoftimit të dipeçerisë)	€/metër linear në ditë ose pjesë të sajë	3.96
<b>3 Tarifat e kalatës / vendakostimit për mjete lundrimi dhe mjete lundrimi shërbimi që qëndrojnë në portin e Durrësit.</b>		
<b>Këto tarifa llogariten bazuar në kategorinë e madhësisë së mjetit të lundrimit në GT dhe/ose gjatësisë së përgjithshme të saj dhe kohën e qëndrimit.</b>		
a Për mjete lundrimi deri në dhe përfshirë 500 GT	€/anije/muaj	117.80
b Për mjete lundrimi mbi 500 GT	€/metër linear në ditë ose pjesë të saj	1.32
e Biga	€/metër linear në ditë	0.83
<b>3.1 Tarifat e kalatës/vendakostimi për skafe turistike</b>		
<b><u>Periudha 1 Qershor – 30 Shtator (periudha e pikut)</u></b>		
a Skafe turistike deri në 5 ml	€/ ditë	10.26
b Skafe turistike deri në 5 ml (për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)	€/ muaj	150.13
c Skafe turistike mbi 5 ml deri në 20 ml	€/ ditë	20.52



d	Skafe turistike mbi 5 ml deri në 20 ml <i>(për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)</i>	€/ muaj	400.00
e	Skafe turistike mbi 20 ml	€/ ditë	61.56
f	Skafe turistike mbi 20 ml <i>(për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)</i>	€/ muaj	1200.00
<b><u>Periudha 1 Tetor – 31 Maj (periudha jashte pikut)</u></b>			
a	Skafe turistike deri në 5 ml	€/ ditë	5.13
b	Skafe turistike deri në 5 ml <i>(për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)</i>	€/ muaj	70.07
c	Skafe turistike mbi 5 ml deri në 20 ml	€/ ditë	10.26
d	Skafe turistike mbi 5 ml deri në 20 ml <i>(për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)</i>	€/ muaj	200.00
e	Skafe turistike mbi 20 ml	€/ ditë	30.78
f	Skafe turistike mbi 20 ml <i>(për mjete me ditë qëndrimi jo më pak se 60 ditë /pagesa fillestare kryhet per jo më pak se dy muaj)</i>	€/ muaj	600.00

## KAPITULLI 2

### TARIFAT E PËRPUNIMIT TË PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES APO MALLIT

#### 2. TARIFAT E PËRPUNIMIT TË ANIJEVE ME MALLRA

##### 2.1 Përkufizime

##### 1 Interpretime

- a "Tarifë përpunimi" (handling charges) do të thotë një tarifë shërbimi ndaj pronarit të anijes apo mallit ose agjentit të tij për ngarkim-shkarkimin e anijes në Portin e Durrësit;
- b "Pronar" do të thotë agjenti, marrësi me qera (charterer) ose zotëruesi i anijes;
- c "Port" do të thotë Porti Durrësit i organizuar sipas Ligjit të Autoritetit Portual Durrës;



d "Çertifikata e tonazhit/Madhësisë së mallit" do të thotë një dokument (psh. Një manifest apo faturë e mallit, listë e mallrave) e lëshuar nga dërguesi i mallrave, pronari, marrësi me qera ose nga agjenti ose agjentët e tyre të cilët lëshojnë madhësinë e mallit në termat ton ose metër kub.

e Vetëm në rast se është specifikuar ndryshe, në këtë kapitull, termi "përpunim" përfshin ngarkimin ose shkarkimin e mallrave dhe konteinerëve dhe imbarkimin apo disimbarkimin e pasagjerëve.

## 2 Aplikime

a Këto tarifa aplikohen në lidhje me mallrat dhe pasagjerët që mbërrinje/ikin me anije të cilat vijnë ne ose përdorin Portin e Durrësit për qëllim ngarkimi ose shkarkimi dhe ose imbarkimi apo disimbarkimi të pasagjerëve dhe RoRo respektivisht.

b Këto tarifa janë të detyrueshme për të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

## 3 Tarifa e Përpunimit (Handling Charges)

a Tarifa e përpunimit do të llogaritet siç është vendosur në tabelën e mëposhtme të tarifave.

b Tarifa e përpunimit e përcaktuar në këtë tarifë është e pagueshme menjëherë dhe mbliidhet nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij (stevedore ose operator terminali të licencuar) në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.

c Detyrimet që lindin nga aplikimi i Tarifës së përpunimit, janë të pavaruara (nuk kanë lidhje), nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

## 4 Madhësia e mallrave

a Nësë janë dy tonazhe bruto ose përmasa të rregjistruara të ndryshme psh ton dhe m3 në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa me e madhe (psh 3 ton dhe 8 m3) do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b Në qoftë se pronari ose agjenti i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë/përmasave të mallit (psh manifest, fature, apo listë mallrash) Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të madhësisë dhe peshës apo volumit të mallit, që do të konsiderohen përmasat e mallit në ton apo metër kub për qëllim të tarifave.

## 5 Përgjashtime

1 Kostot e përpunimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:



- a Një Luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;
- b Një anije që i përket Qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;
- c Një anije e përjashtuar nga pagesa, e të tilla tarifave si rezultat ndonjë marrveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

## 2.2 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave rifuxho

- 1 Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose Stivadori i licencuar përkundrejt pronarit ose agentit të anijes dhe/ose mallit, për ngarkimin ose shkarkimin e anijes.
- 2 Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të shkarkimit të anijes
  - i Shkarkimi nën drejtimin/orientimin e komandës së Anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet;
  - ii Lëvizja e mallrave nga vendi i shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda të njëjtës zonë të terminalit në afërsi të kalatës.
  - iii Vendosja e mallrave nga magazina ose sheshi hapur në automjetin e dorëzimit.
- 3 Shërbimet e përfshira në tarifë në rast ngarkimi të anijes:
  - i Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura;
  - ii Lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësire të të njëjtit terminal) në port nga pika e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura, përgjatë kalatës së anijes;
  - iii Ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së Anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.
  - iv Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkimi i mallrave në të njëjtën zonë/kalatë në port nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;
- 4 Shërbimet nën këto përkufizime nuk përfshijnë:
  - i Sistemimin (trimming) në hambarin e Anijes të mallrave rifuxho;



- ii Hapjen dhe mbylljen e kapakut të hambarit;
- ii manipulimin e pajisjeve të anijes;
- iv Numrimin e mallit;
- v furnizimi i pajisjeve ose i ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;
- vi Furnizimin me material dhe konstruktimin në hambarin e anijes më qëllim të ndarjes së mallrave;
- vii Lëvizja e mallrave ndërmjet zonave të ndryshme të portit (përfshihet zona e dy kalatave fqinje);

*të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime për të cilat do të aplikohen pagesa më vete.*

### 2.3 Tarifat për perpunimin e Mallrave të Rënda Rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia	Çmimi (Lek)
	<b>Bazë</b>		
	1 Qymyr	Lek/ton	500.36
	2 Minerale, koncentrate dhe ferrot e tyre (krom, hekur nikel, baker, pirit, silic etj.)	Lek/ton	681.75
	3 Materiale ndërtimi: (Klinker, materiale inerte, zhavorr, rërë, gurë, gëlqere, rërë xhami, dolomite, barite, etj.)	Lek/ton	581.67
	4 Cimento rinfuze me pompë vakumi	Lek/ton	548.31
	5 Skrap	Lek/ton	659.85
	6 Tarifa për sigurinë	Lek/ton	14.60
	7 Mallra të rrezikshme (sipas IMO/IMDG code)	Lek/ton	Shtesë 100% mbi tarifën standarte



#### 2.4 Tarifat për përpunimin e mallrave të lehta rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia Bazë	Çmimi (Lek)
1	Squfur	Lek/ton	664.02
2	Grurë, Drithëra, Ushqim për kafshët	Lek/ton	710.93
3	Plehra kimike, kripë e të tjera të ngjashme	Lek/ton	599.39
4	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	Lek/ton	Shtesë 100% mbi tarifën standarte
5	Tarifë për sigurinë	Lek/ton	14.60

#### 2.5 Tarifat për përpunimin e mallrave të lëngshme

Njësia	Artikulli	Njësia Bazë	Çmimi (Lek)
1	Ngarkim/shkarkim të mallrave të lëngshëm në kalatë (verë, vaj ushqimor, etj)	Lek/ton	291.88
2	Shkarkimi i produkteve të lëngshme në pontil.	Lek/ton	222.86
3	Shkarkimi i benzinës, benzol, vajguri (avionash) në kalatë	Lek/ton	583.75
4	Karburant, mazout, bitum në kalatë	Lek/ton	291.88
5	Tarifa e sigurisë	Lek/ton	14.60
6	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	Lek/ton	Shtesë 100% mbi tarifën standarte

#### 2.6 Përkufizime mbi Përpunimin e Mallrave Gjenerale

- 1 Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose Stivador përkundrejt pronarit ose agjentit të anijes dhe ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin në/nga anija.
- 2 Shërbimet e përfshira në tarifë, në rast të shkarkimit të anijes:
  - i Shkarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së Anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet;



- ii Lëvizja e mallrave nga pika e shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda të njëjtës zonë të terminalit në afërsi të të njëjtës kalate.
- iii Vendosja e mallrave nga magazina ose sheshi i hapur në automjetin e dorëzimit.
- 3 Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të ngarkimit të anijes
  - i Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura;
  - ii Lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësirë të të njëjtit terminal dhe kalatë) në port nga pika e depozitimit (magazinë ose në sheshe të hapura) përgjatë anijes;
  - iii Ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së Anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.
  - iv Shkarkim në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkim i mallrave brenda të njëjtës zone në port nën drejtimin e komandës së Anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;
- 4 Shërbimet nën keto përkufizime nuk përfshijnë:
  - i Lidhjen dhe zgjidhjen (lashing and unlashing) e Mallrave ose konteinerëve;
  - ii Hapje mbyllje të hambarit;
  - ii manipulimin e pajisjeve të anijes (rigging of ship's gear);
  - iv Numrimin e mallit ose konteinerëve;
  - v furnizimi i pajisjeve ose i ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;
  - vi lëvizje ekstra (shifting) e mallrave ose konteinerëve në hambarë të anijes, ose në anije ose në kalatë përgjatë kalatës ose në magazinë apo sheshe;
  - vii Rikuperimi i paketimit të mallrave të dëmtuara;
  - viii Mbledhja e mallrave të derdhura ose shpërndara në vendet e mbledhjes ose ndonjë aktivitet i ngjashëm;
  - ix) lëvizja apo paraqitja e mallrave në përmbushje të kërkesës së doganës për kontroll doganor;
  - x) çdo aktivitet tjetër që nuk është përshkruar në 2) ose 3); të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime që do të paguheshin më vete.





<b>2.7 Tarifave për përpunimin e Mallrave Gjenerale</b>		<b>Njësia Bazë</b>	<b>Cmimi (Lek)</b>
<b>Nr.</b>	<b>Artikulli</b>		
1	(Normal) Mallra gjenerale si Fuci, ballo, binare, rrumbuj, koli celiku, hekur, llamarinë, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme, etj deri dhe përfshirë 1500 kg / njësi.	Lek/ton	579.58
2	(Të rënda) Ngarkesa të rënda fuci, ballo, binarë, rrumbuj, koli celiku, hekur, llamarinë, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme, etj mbi 1500 kg / njësi.	Lek/ton	502.44
3	(Shumë të rënda) Ngarkesa të rënda dhe me përmasa të mëdha (makineri, pajisje, etj. të cilat nuk përfshihen në këtë libër tarifash) mbi 5000 kg/njësi. *	Lek/ton	2,189.07
4	(Të lehta) Box, të ndryshme, ngarkesa të lehta dhe gabarite (ambalazhe, goma, depozita uji dhe mallra mbi 3 m3.	Lek/ton	1,203.99
5	Ngarkesa me thasë.	Lek/ton	677.57
6	Ngarkesa të paletizuara apo pre-paketuara (big bags, slinga etj.)	Lek/ton	646.30
7	Ngarkesa që prishen (paleta, pako, thasë, si psh. fruta të freskta, banane, zarzavate, mish i ngrirë, vezë, etj.)	Lek/ton	shtesë 25 % mbi tarifën standarte
8	Bllloqe mermeri (çfarëdo madhësie)	Lek/ton	502.44
9	Ngarkesa të rrezikshme (eksplozive, lëndë djegëse sipas kodit IMDG)	Lek/ton	Shtesë 100% mbi tarifën standarte
10	Tarifë për sigurinë	Lek/ton	19. 81
<b>2.8 Përkufizime të tjera për Imbarkimin/Disimbarkimin e Pasagjerëve</b>			
1)	Këto tarifa paguhen nga zotëruesi i anijes ose agjenti i tij, për imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve në / nga anija dhe mblidhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.		
2)	Shërbimet e përfshira në këtë tarifë janë:		
i)	Sigurimi i faciliteteve të pasagjerëve dhe shërbimet lidhur me to në Portin e Durrësit duke lejuar hyrje dhe dalje të sigurtë në/nga anijet e ankoruara në kalatë;		



- ii) Ofrimi i sigurisë, faciliteteve dhe shërbimeve të sigurta në Portin e Durrësit;
  - iii) Strehimi dhe facilitetet/objektet e duhura sanitare;
  - iv) Përpunimi i dokumentacionit përkatës.
- 3) Shërbimet sipas këtyre përkufizimeve nuk përfshijnë:
- i) Çdo shërbim tjetër që nuk është përmendur në pikën 2), i cili mund të jetë shërbim që faturohet dhe paguhet më vete.
- 4) Për qellim të kësaj tarife, të rriturit janë persona 12 vjeç e sipër. Më kërkesë të Autoritetit Portual Durrës ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, pasagjerët duhet të paraqesin dokumentin e tyre të identitetit (p.sh pasaporta ose kartën e identitetit) për të lejuar kështu Autoritetin Portual ose përfaqësuesin e tij të autorizuar të verifikojë moshën e tyre.

### 2.9 Tarifat e imbarkimit/disimbarkimit të pasagjerëve me tragete

Njësia	Artikulli	Njësia Bazë	Detyrimi (€)
1	<b>Tarifë fikse për çdo mbërritje të tragetit</b>		11.88
2	<b>Imbarkimi i pasagjereve</b>		
a	Pasagjerë nën 12 vjeç	Person	2.08
b	Pasagjerë mbi 12 vjeç	Person	4.17
c	Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	Person	0.55
3	<b>Disimbarkimi i pasagjerëve</b>		
a	Pasagjerë nën 12 vjeç	Person	1.04
b	Pasagjere mbi 12 vjeç	Person	2.09
c	Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	Person	0.55

### 2.10 Përkufizime të tjera për përpunimin Roll-on/Roll-off të ngarkesave

- 1 Këto detyrime janë vendosur nga Autoriteti Portual ose Stevedore ndaj zotëruesit ose agjentit të anijes dhe/ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin Roll-on/Roll-off të mallrave në /nga Anijet, Tragetet e pasagjerëve, mbajtësit e makinave ose të anijeve të ngjashme.
- 2 Në rast të shkarkimit të anijes, në tarifën e shërbimit përfshihet:



- i Lëvizja e ngarkesës nën drejtimin e komandës së anijes nga kuverta e Anijes deri në vendin e qëndrimit, në terminalin e portit.
- ii Dorëzimi i ngarkesës, nga vendi i qëndrimit në terminalin e portit, pronarit të ligjshëm ose përfaqësuesit.
- 3** Në rast të ngarkimit të anijes, në tarifën e shërbimit përfshin:
  - i Marrjen e ngarkesës nga transportuesi dhe lëvizjen e saj në drejtim të pikës së qëndrimit në terminalin e portit.
  - ii Lëvizjen e ngarkesës nga vendi i qëndrimit në rampat e anijes dhe lëvizjet e mëtejshme nën drejtimin e komandës së anijes në hambarin ose kuvertën e anijes.
- 4** Këto shërbime nuk përfshijnë:
  - i Lidhjen, zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në anije.
  - ii Lidhjen, zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në trailer, mjet apo shasi e cila është përgjegjësi e pronarit të mjetit.
  - iii Rimorkimin dhe/ose lëvizjen e makinave me mjete dhe /ose nëse janë apo jo vetështytëse nga personeli i portit dhe/ose stevedorit, në terminalin e portit ose/dhe në hambarin ose në kuvertën e anijes, kur ato nuk kanë lidhje direkt me procesin e ngarkim shkarkimit.
  - iv Ndihma për ndezjen e motorit.
  - v Spontimi ose aktivitete të ngjashme.
- 5** Në lidhje me këto tarifa termi “automjet” përfshin Kamion, gjysëm rimorkiator, gjysëm rimorkio, rimorkio, automjete për transport të veçantë, Automjete për përdorim të veçantë, Automjete bujqësore, Automjete teknologjike industriale.
- 6** Nëse nuk është shprehur ndryshe, termi “automjet” përfshin dhe autoveturat.

#### **2.11 Tarifat e përpunimit të automjeteve dhe makinave (Mallra Ro/Ro)**

<b>1 Ngarkimi automjeteve</b>	<b>Njësia bazë</b>	<b>Detyrimi (€)</b>
a Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 ton	Automjet	6.25
b Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 ton	Automjet	10.42
c Automjete mbi 7,5 ton	Automjet	13.55
<b>2 Shkarkimi i automjeteve</b>	<b>Njësia bazë</b>	<b>Detyrimi (€)</b>



a	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 ton	Automjet	3.13
b	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 ton	Automjet	4.50
c	Automjete mbi 7,5 ton	Automjet	4.50
<b>3</b>	<b>Shërbime për ngarkimin ose shkarkimin e mjeteve apo ngarkesave</b>	<b>Njësia bazë</b>	<b>Detyrimi (€)</b>
a	Rimorkimin e ngarkesës Ro/Ro me kokat tërheqëse, në dy mënyrat, psh. Ngarkim, ose shkarkim.	Për njësi	20.85
b	Shërbimi i drejtimit të mjetit <sup>1</sup>		
1)	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 ton	Automjet	4.50
2)	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 ton	Automjet	6.25
<b><sup>1</sup> Për rastet kur mjetet imbarkohen apo disimbarkohen duke u drejtuar nga punonjësit e autorizuar të Terminalit të Trageteve.</b>			
3)	Automjete mbi 7,5 ton	Automjet	10.42
	Dhënia me qera e Lifterakut të portit në terminalin b/1 e trageteve për përpunimin e mallrave në bord të anijes.	Njësi/orë	25.02
c.	Pagesa e një tarife sigurie për makinat, furgonat, (deri, përfshirë 3.5 ton) në të dy mënyrat; psh. Ngarkim ose shkarkim *	Për njësi	1.04
d.	Pagesa e një tarife sigurie për kamionat/trailerat, (mbi 3.5 ton) në të dy mënyrat psh. Ngarkimin ose shkarkimin*	Për njësi	2.08
e.	Tarifë për përpunimin e paletave në shesh	Për Paletë	3.65

## 2.12 Përkufizime të tjera për përpunimin e Konteinerëve

1 Këto detyrime janë vendosur nga Autoriteti Portual, Stivadori i licencuar ose operatori i Terminalit, ndaj pronarëve ose agjentit të anijes dhe ose mallit për ngarkimi ose shkarkimin e konteinerëve (ose flat racks) në/prej anijeve.

2 Në rastin e shkarkimit të anijeve, tarifa e shërbimit përfshijnë:



i Shkarkimin e konteinerit nën drejtimin e komandës së anijes nga hambari ose kuverta e anijes, në pikën e shkarkimit në kalatën e portit.

ii Lëvizja e konteinerit nga pika e shkarkimit për në vendin (slotin) e caktuar në sheshin e portit (terminalit të kalatës së anijes);

iii Dërgimi (ngarkimi) i konteinerit nga pika e shkarkimit në zonën (slotin) e caktuar të sheshit të portit (terminalit), për në kamionin e marrësit të ngarkesës.

**3** Në rastin e ngarkimit të anijes, tarifa e shërbimit përfshin:

C3	Ka peshkuar në një zonë të ndaluar, gjatë një periudhe kohore në të cilën ndalohet peshkimi me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, ose ka peshkuar në një zonë të ndaluar, pa pasur një kuotë për këtë peshkim, ka peshkuar në një zonë të ndaluar kur ka mbaruar kuotën, ose ka peshkuar në një thellësi të ndaluar në zonën e ndaluar (shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, të pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).
C4	Ka imbarkuar, transborduar ose zbarkuar peshq me madhësi më të vogël se madhësia e përcaktuar në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi (shkronja “h”, e pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).
C5	Ka kryer transbordime ose ka marrë pjesë në veprimtari të peshkimit të përbashkët me mjete lundruese të identifikuara si mjete që zhvillojnë aktivitet PPP, në mënyrë të veçantë atyre të përfshira në listën e anijeve PPP kombëtare ose të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit ose i ka dhënë ndihmë ose furnizuar këto anije (shkronjat “i”, “j”, “k”, të pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).
D1	Nuk ka respektuar detyrimet e lidhura me regjistrimin dhe deklarimin e të dhënave për zëniet ose të dhënave të lidhura me to, përfshirë këtu dhe të dhënat që transmetohen nëpërmjet satelitit ose lajmërimit paraprak; (shkronja “b” e pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).
E1	Ka përdorur një mjet lundrues që është pa kombësi, sipas kushteve të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare (shkronja “ll”, e pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).
F1	Ka përdorur një mjet lundrues që është pa kombësi, sipas kushteve të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare (shkronja “ll”, e pikës 1, të nenit 117, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar).



**VENDIM**  
**Nr. 18, datë 4.4.2023**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 4.4.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (H) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE:** Shoqëria Hydroenergy sh.p.k.

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

Shoqëria “Euro-AP” sh.p.k.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1353 (253), datë 20.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuësja është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe ka objekt të veprimtarisë

së saj financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e HEC-eve, si dhe prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë elektrike. Fillimisht, ajo përbëhej nga dy ortakë, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k. dhe shoqëria “Energy Solution” sh.p.k. Pas blerjes së disa kuotave nga shoqëria “Sol” sh.p.k., kërkuësja përbëhet nga shoqëria “Sol” sh.p.k. dhe shoqëria “Euro-AP” sh.p.k.

2. Asambleja e Ortakëve ka marrë disa vendime për shitblerjen e kuotave dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë. Në datën 13.3.2017 kërkuësja ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të datës 24.2.2017, për stabilizimin e situatës financiare të shoqërisë, duke zmadhuar kapitalin e shoqërisë me një shumë prej 9.000.000 eurosh, si dhe raportin e ekspertit për zmadhimin e kapitalit. Me këto akte kanë ndryshuar kuotat e pjesëmarrjes së ortakëve. Konkretisht, kuotat e shoqërisë “Euro-AP” sh.p.k. nga 25% ka shkuar në 3.96%, ndërsa kuotat e shoqërisë “Sol” sh.p.k. nga 75% kanë shkuar në 96.04%.

3. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje dhe me pretendimin se nuk ishin respektuar përcaktimet e nenit 13 të statutit të shoqërisë, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k. ka ngritur padi në gjykatë, me objekt rivendosjen e së drejtës së interesit të ligjshëm të cenuar, ndalimin e cenimit të së drejtës së kuotës së kapitalit, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10029, datë 27.11.2017, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Vendimi është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2018-407, datë 25.1.2018.

4. Në vijim, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k. ka ngritur edhe një padi tjetër, me objekt shfuqizimin si të pavlefshëm të vendimit të Asamblesë së Ortakëve të datës 24.2.2017 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8104, datë 8.10.2018, ka vendosur sërish nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim.

5. Shoqëria “Euro-AP” sh.p.k. ka ngritur përsëri padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt interpretimin e kontratës së themelimit të shoqërisë të lidhur ndërmjet saj dhe kërkueses, shfuqizimin e vendimit të mbledhjes së Asamblesë



së Ortakëve të datës 24.2.2017, si një akt absolutisht i pavlefshëm, kthimin në gjendjen e mëparshme të kapitalit në shoqëri, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Edhe në këtë rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 800, datë 18.2.2022, ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes, duke arsyetuar se, nisur nga përcaktimet statutoare dhe kontraktore, palët, me vullnetin e tyre të lirë, kanë zgjedhur zgjidhjen e konflikteve nëpërmjet procedurës së arbitrazhit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim të veçantë shoqëria “Euro-AP” sh.p.k. dhe kundërankim kërkuesja. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-953 (214), datë 6.6.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Më pas, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k., bazuar në nenet 494, 496, 497 dhe 498 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 00-2018-407, datë 25.1.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin ishte vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 10029, datë 27.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Ajo ka paraqitur si shkak rishikimi faktin se dispozitat ligjore që parashikonin dhe rregullonin krijimin dhe funksionimin e arbitrazhit janë shfuqizuar dhe qendra “Medart” që duhet të kryente procedurën e arbitrazhit, nuk funksionon prej vitit 2017. Sipas saj, bazuar në pikën 22.4 të nenit 22 të kontratës së koncesionit, së cilës i referohet edhe neni 28 i statutit të kërkueses, zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes procedurës së arbitrazhit është e zbatueshme vetëm nëse nuk bie ndesh me ndonjë rrethanë, fakt ose ngjarje që e bën të pamundur ekzekutimin e saj. Për rrjedhojë, mosmarrëveshja i përket juridiksionit gjyqësor.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2022-1353 (253), datë 20.6.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim, prishjen e vendimit nr. 00-2018-407, datë 25.1.2018 të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 10029, datë 27.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar dërgimin e çështjes pranë kësaj të fundit për vazhdimin e gjykimit. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkesa për rishikim plotëson kushtet e parashikuara nga neni 494 i KPC-së, për faktin se prej shumë vitesh

qendra “Medart” nuk ushtron më veprimtarinë e saj.

8. Në datën 7.11.2022 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për pranimin e kërkesës për rishikim. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 16.12.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në kërkesën e paraqitur nga subjekti i interesuar, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k., me vendimin nr. 559, datë 14.2.2023, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Vendimi nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

**10. Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

10.1 *Parimin e kontradiktoritetit, të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar. Për pasojë, asaj i është mohuar e drejta për t'u shprehur dhe kundërshtuar shkaqet e kërkesës për rishikim.

10.2 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi ai është në kundërshtim me arsyetimin dhe konkluzionet e vendimit nr. 00-2022-953 (214), datë 6.6.2022 të vetë Gjykatës së Lartë, me të njëjtat palë dhe objekt, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

**11. Subjekti i interesuar, shoqëria “Euro-AP” sh.p.k.**, nuk ka paraqitur prapësime, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe neni 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të



vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, person fizik ose juridik, si një prej subjekteve të kushtëzuar, kur kundërshton procesin ligjor, ka detyrimin të provojë se në ç'mënyrë është prekur në të drejtat e tij kushtetuese si pasojë e parregullsisë së këtij procesi. Interesi i tij për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe ai duhet të konsistojë tek e drejta e shkelur dhe te dëmi real i shkaktuar (*shih vendimin nr. 12, datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuësja ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor nr. 00-2022-1353 (253), datë 20.6.2022 i Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar prej saj. Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Lartë ka pranuar kërkesën për rishikim, duke prishur vendimet gjyqësore të mëparshme për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe duke urdhëruar vazhdimin e gjyimit në shkallë të parë. Ndërkohë që ankimi kushtetues ishte në shqyrtim e sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 559, datë 14.2.2023, ka pushuar gjykimin, bazuar në kërkesën e subjektit të interesuar (paditës në atë gjykim) dhe me pëlqimin e kërkuësës (e paditur në atë gjykim). Vendimi i pushimit nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve dhe sekretaria gjyqësore ka vënë shënimin se ka marrë formë të prerë në datën 15.3.2023. Kjo do të thotë se në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk ka një proces gjyqësor që po shqyrton sërish të drejtën ose interesin e ligjshëm të kërkuësës, që me vendim gjyqësor përfundimtar ishte nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor.

15. Kërkuësja, e pyetur nga Gjykata, parashtroi me shkrim se kjo rrethanë e re nuk ndikon në shqyrtimin e ankimit kushtetues. Sipas saj, vendimi

i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është ende në fuqi dhe nuk pajtohet me Kushtetutën për shkaqet e paraqitura në kërkesë.

16. Në këto rrethana, Gjykata vëren se objekt i gjyimit kushtetues është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim, i cili i hapi rrugën juridiksionit gjyqësor të zakonshëm. Edhe pse gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e gjyimit në atë juridiksion, vendimi i pushimit, në bazë të dispozitave ligjore procedurale, është vendim jopërfundimtar dhe nuk përbën pengesë për ringritjen e padisë në të ardhmen (nenet 127 dhe 300 të KPC-së), duke e bërë në këtë mënyrë të zbatueshëm vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuësja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen kushtetuese të parashtruar, ndaj ajo legjitimohet *ratione personae*.

17. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon kundërshtimit të procesit të rishikimit, Gjykata ka pohuar se duke qenë se ai është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuësi nuk ka mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 18, datë 23.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata çmon se në rastin konkret plotësohet edhe kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuësi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 24.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkuësja i është drejtuar asaj në datën 7.11.2022,



ndërsa vendimi i kundërshtuar është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 20.6.2022. Kërkesja i ka bashkëngjitur ankimit kushtetues edhe një shkresë të kancelarit të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës vendimi i kundërshtuar është përgatitur për publikim në datën 19.9.2022 dhe është bërë i aksesueshëm për palët në faqen e internetit në datën 1.11.2022. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja pretendon se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e kontradiktoritetit, së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe parimit të sigurisë juridike, të garantuara respektivisht nga nenet 4 dhe 42 të Kushtetutës. Këto pretendime hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

#### B. Për themelën e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar

21. Kërkesja pretendon se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, ndaj ajo nuk ka marrë dijeni për gjykimin e zhvilluar. Në këtë mënyrë, ajo nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet, faktet dhe provat kundër kësaj kërkesë, duke iu cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe parimet e kontradiktoritetit dhe të sigurisë juridike.

22. Subjekti i interesuar, shoqëria "Euro-AL" sh.p.k., nuk ka paraqitur prapësime, por ka informuar Gjykatën nëpërmjet postës elektronike se nuk do të vazhdojë më rrugën gjyqësore dhe se do të ndjekë procedurat e arbitrazhit.

23. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

24. Në jurisprudencën kushtetuese për procesin e rregullt, Gjykata është shprehur se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e standardeve të tjera. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në

gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, kjo e drejtë krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 8, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Lidhur me kërkesat për rishikim, Gjykata ka vlerësuar se rifillimi i procesit gjyqësor nga e para, pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë të prerë e vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për të shprehur e mbrojtur pretendimet e tyre, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt. Çdo provë e paraqitur nga pala, që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi palës tjetër të shprehë pretendimet e saj, sepse ajo nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta që i është njohur me vendim të formës së prerë të gjykatave. Në raste të tilla, standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive, është shansi i barabartë për të qenë e pranishme në një proces ku do të shqyrtohet pozita e saj juridike (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). KPC-ja e përcakton kërkesën për rishikim si mjet ankimi, ndërsa nuk e përjashton Gjykatën e Lartë nga detyrimi për t'ia njoftuar këtë kërkesë palës tjetër. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër, është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrorë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimin nr. 5, datë 26.1.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kemi cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, në rastet kur kërkesa për rishikim nuk i dërgohet palës tjetër dhe kur ajo nuk thirret për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 8, datë 2.5.2006; nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vëren se kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtje të KPC-së, e cila e përcakton kërkesën për rishikim si një prej mjeteve për t'u ankuar ndaj



vendimeve të gjykatave (*neni 442*). Çdo akt ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të këtij kodi, për njoftimet e thirrjet në gjykatë (*neni 447*). Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi (*neni 497, pika 1*). Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomë këshillimi. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj. Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (*neni 482, pikat 1–3*).

27. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk rezulton t'i ketë komunikuar kërkesues kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e kohës së shqyrtimit të kësaj kërkesë nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj dhe në faqen e internetit. Duke mos marrë njoftim për aktin e ankimit “kërkesë për rishikim”, njoftimi për kohën e shqyrtimit të tij ka mbetur formal, pasi kërkesja efektivisht ka qenë në pamundësi të paraqesë prova, fakte dhe argumente për çështjen në gjykim.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, të parashtruara në kërkesën për rishikim, pa dëgjuar pretendimet e kërkesues, e cila është vënë në pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër. Në këtë mënyrë, kërkesja, duke mos u njoftuar për paraqitjen e kërkesës për rishikim dhe shkaqet e paraqitura në të, është vënë në pamundësi të paraqesë pretendimet e saj, ndaj Gjykata çmon se është i bazuar pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në

aspektet e së drejtës së mbrojtjes, së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit.

29. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson të mos të ndalet në analizimin e pretendimit tjetër të kërkesues për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, e cila, në zbatim të rolit subsidiar të saj, duhet të shprehet edhe për këtë pretendim.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe duhet të pranohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

#### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
  2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1353 (253), datë 20.6.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
  3. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 4.4.2023.**

**Shpallur më 28.4.2023.**

**Kryetare:** Holta Zaçaj,

**Anëtarë:** Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim



**NJOFTIM**  
**Nr. 7630, datë 26.4.2023**

**NJOFTIM MBI HYRJEN NË FUQI TË**  
**MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për viza”, nënshkruar në datën 22 shtator 2022, ka hyrë në fuqi në datën 25 prill 2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME  
**Gazmend Turdiu**

**VENDIM**  
**Nr. 109, datë 27.3.2023**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE**  
**SHQIPTARE (KESH) SHA”, NË**  
**VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-i**  
**LUNDRUES I INSTALUAR NË PORTIN**  
**E TRIPORTIT NË GJIRIN E VLORËS**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 308/11 prot., datë 24.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i lundrues, i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, i përbërë nga dy gjenerues Tigr 1 dhe Tigr 3, për një afat 2-vjeçar (dyvjeçar).

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.12.2022 dhe 31.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.1.2023, periudha e pritjes së komenteve është 30 ditë pasi TEC-i është i lidhur në OST), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 24.2.2023, vendosi të zgjasë me 30 ditë vendimmarrjen e tij, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) sh.a., pasi u konstatua se shoqëria dokumentoi në ERE se ishte pajisur me miratimin paraprak të pikës së lidhjes e ishte në proces për miratimin e marrëveshjes së lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe kishte aplikuar për marrjen e lejes së përdorimit të burimit ujor.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 350/2022 me shkresën nr. 2074/3 prot., datë 30.12.2022, dhe e ka kujtuar për plotësimin e dokumentacionit të munguar, me shkresën me nr. 308/2 prot., datë 7.1.2023. KESH sh.a. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 308/1 prot., datë 1.2.2023, nr. 308/6 prot., datë 24.2.2023, nr. 308/9 prot., datë 20.3.2023, dhe nr. 308/10 prot., datë 24.3.2023.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).





- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria KESH sh.a. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

- Në kuadër të mbikëqyrjes dhe të zbatimit të kushteve të licencës, shoqëria të depozitohet në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe vitit 2021, brenda datës 31.7.2023.

- Në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se kontrata e qirasë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti termik Tigr 1 dhe Tigr 3, është nënshkruar për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare) vjeçare, duke filluar ky afat nga data e komisionimit të veprës, pra kur asetet bëhen operacionale, ERE do të kushtëzohet nga ky afat në përcaktimin e vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.” në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-i lundruar i instaluar në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 2-vjeçar, duke filluar nga data e komisionimit të veprës, të përbërë nga dy gjenerues:

- a) “Tigr 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw.
- b) “Tigr 3”, me kapacitet të instaluar 60 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 110, datë 27.3.2023

### **MBI KËRKESËN E OST SHA, PËR INTERVALIN KOHOR 1 ORË NË OPERIMIN E PROCESVE TË TREGUT BALANCUES DHE NOMINIMEVE TË TRANSAKSIONEVE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 576/4 prot., datë 24.3.2023 të përparitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. në funksion të operimit në Tregun Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nëpërmjet shkresës nr. 756 prot., datë 3.2.2023, protokolluar e ERE me nr. 576 prot., datë 6.2.2023, ndër të tjera ka parashtruar argumentet, kushtet, si dhe vlerësimet mbi implementimin e platformës së menaxhimit të tregut për intervalin kohor 1 orë ku vlerëson se nuk mund të operohet me rezolucion 15 minuta.

- Shoqëria OST sh.a., ndër të tjera deklaroi se në vijim të operimit me bazë orare për llogaritjen e disbalancave, për proceset në tregun balancues dhe për proceset e nominimit, ka bërë reflektimet e saj duke i përcjellë si draftpropozime të Rregullave të



Tregut Shqiptar të Balancimit. Gjithashtu në vijim të zhvillimeve rajonale, OST sh.a. shprehet se ka infrastrukturën e nevojshme për të vepruar si vendet e rajonit për sa i përket tregut balancues.

- Në zbatim të urdhrit nr. 33, datë 24.2.2023, ERE, organizoi një seancë dëgjimore, mes përfaqësuesve të shoqërisë OST sh.a., Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe “Albanian Power Exchange” (“Alpex”) sh.a. për të diskutuar lidhur me kooperimin e platformës së menaxhimit të tregut me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë e cila është me rezolucion orar, duke marre në konsideratë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

- OST sh.a., përgjatë periudhës kohore nga 1 prill 2021, momenti kur ka filluar operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, nuk ka aplikuar rezolucionin 15 minutësh, si periudhë kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, por intervalin kohor prej 1 orë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 22.4.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-të e Evropës kontinentale, anëtare të ENTSO - E, që nga data 1 qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a., aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm, përkundrazi aplikimi i afatit kohor prej 1 ore edhe në tregun e brendshëm të balancimit ndikon në harmonizimin e këtyre proceseve.

- Vlerësimi i dhënë nga “AAES”, e cila e konsideron si pozitiv funksionimin e tregut shqiptar të balancimit në rezolucionin 15 minutësh, pasi kontribuon në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik është një vlerësim i saktë dhe adreson në mënyrë të drejtë këtë çështje.

- Duke qenë se për periudhën në vijim të vitit 2023, “Alpex” sh.a. pritet të fillojë operimin komercial të tregut të energjisë elektrike, gjykojmë

të arsyeshme pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a. Për periudhën 1 prill 2023 deri më 1 prill 2024, pra për një vit të operohet në tregun e balancimit të energjisë elektrike me intervalin kohor prej 1 ore. Gjatë kësaj periudhe kohore 1-vjeçare do të mund të vlerësohet ecuria e operimit të tregut që do të operohet nga “Alpex” sh.a. dhe tregut të balancimit që operohet nga OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a., “Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore, për periudhën 1 prill 2023 deri më 1 prill 2024.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 111, datë 27.3.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“TPLANI HC” SHPK, NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HIDROCENTRALI “VALBONA”, NË  
LUMIN E VALBONËS, BASHKIA  
TROPOJË, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 2100 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “a”, dhe 39 pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4,



pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe neneve 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/17 prot., datë 24.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Tplani HC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Valbona’, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 27.1.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tplani HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.1.2023 dhe 1.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 99/6 prot., datë 7.2.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi me shkresat e protokolluara në datat 9.2.2023, 15.2.2023 dhe 23.2.2023.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtijshme me shoqërinë, me qëllim saktësimin e disa dokumenteve në kuadër të këtij aplikimi, me vendimin e Bordit nr. 57, datë 24.2.2023, u vendos të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Tplani HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresat e protokolluara në ERE në datat 24.2.2023, 3.3.2023, 6.3.2023, 16.3.2023, dhe 23.2.2023, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Tplani HC” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “f”.

- Shoqëria nuk ka depozituar lejen për përdorimin e burimit ujor për prodhimin e energjisë elektrike për HEC “Valbonë”, por ka dokumentuar aplikimin dhe ka bërë me dije se është në proces të marrjes së kësaj leje, dhe duke qenë se leja për përdorimin e burimit ujor përbën një dokument thelbësor për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, vlerësohet që shoqëria të licencohet me kushtin që, përpara fillimit të operimit të depozitohet në ERE lejen për përdorimin e burimit ujor.

- Pika e lidhjes e miratuar nga OSHEE sh.a. është për kapacitetin 2.1 MW, në nenin 8.6 të kontratës së koncesionit të nënshkruar me METE-n (Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë), sanksionohet se koncesionari duhet të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentralit “Valbona”, me fuqi totale jo më pak 2300 kw, kurse subjekti vetë ka kërkuar saktësim të fuqisë për 2.4 mw. Në



këto rrethana, për sa kohë që nuk ka një miratim tjetër nga operatori i rrjetit, vlerësohet që si kapacitet i instaluar do të merret në konsideratë ai i përcaktuar në pikën e lidhjes së miratuar, prej 2100 kw.

- Kontrata e koncesionit nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.1.2009, ka një afat 35-vjeçar, por ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 14 vjet e 2 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 20 vjet e 10 muaj. Ndaj shoqëria do të licencohet për afatin e mbetur.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Tplani HC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw, për një afat 20 vjet e 10 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të depzoitojë në ERE lejen për përdorimin e burimit ujqor.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 112, datë 27.3.2023

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 161, DATË 17.6.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘VOKOPOLA ENERGJI’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et ‘VOKOPOLA 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw, ‘VOKOPOLA 2’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw, DHE ‘VOKOPOLA 3’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 143/4 prot., datë 24.3.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energi’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instalua 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 161, datë 17.6.2022, ka licencuar shoqërinë “Vokopola Energi” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.



- Në vijim, bordi i ERE-s me vendimin nr. 311, datë 30.11.2022, ndër të tjera ka vendosur:

- Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitohet brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit:

a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;

c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

- Me dokumentacionin e depozituar në ERE, rezulton se shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. ka plotësuar germën “a” dhe “d”, të pikës 2, të vendimit nr. 161/2022, i ndryshuar, ndaj vlerësohet që të shfuqizohen.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në germën “b” të pikës 2, të vendimit nr. 161/2022, i ndryshuar shoqëria ka depozituar në ERE kontratat e rinovuara, përkatësisht me Bashkinë Skrapar (afati i vlefshmërisë deri më 19.12.2023), Bashkinë Poliçan (afati i vlefshmërisë deri më 30.10.2024) dhe Bashkinë Memaliaj (afati i vlefshmërisë deri më 20.12.2023), ndaj vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të paraqesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë germat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 161, data 17.6.2022, i ndryshuar.

2. Pika 2, e vendimit nr. 161, datë 17.6.2022, i ndryshuar, ndryshon si vijon:

Shoqëria “Vokopola Energy” sh.p.k., të paraqesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

## VENDIM

Nr. 113, datë 27.3.2023

### **MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/6 prot., datë 24.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe



Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘Energy Market Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 24.2.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.2.2023 dhe 26.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 887/4 prot., datë 3.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 887/5 prot., datë 24.3.2023, shoqëria ka depozituar në ERE informacion plotësues të aplikimit dhe po ashtu ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të zgjatur afatin e depozitimit nga ana e saj të dokumentacionit plotësues të këtij aplikimi.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim që të shqyrtohet dokumentacioni i depozituar së fundmi nga shoqëria, çka mund të sjellë nevojën e zhvillimit të një korrespondence të mëtejshme me të, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

## VENDIM

Nr. 114, datë 27.3.2023

### **MBI MIRATIMIN E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË “OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” (OSSH) SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 72 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “F”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.2 dhe pikës 2 të Programit të Pajtueshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 21.12.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 1014/1 prot., datë 24.3.2023, “Mbi miratimin e Zyrtarit të



Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.”,

konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, vendosi të miratojë Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë (ZP) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dëjani e këtij vendimi të përcjellë për miratim në ERE Zyrtarin e Pajtuëshmërisë, pas miratimit nga organet drejtuese të saj, e po ashtu të dokumentojë në ERE plotësimin nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë të kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1 të kontratës.

- ERE njoftoi shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e mësipërm me shkresën e ERE-s nr. 132 prot., datë 16.1.2023, ndërsa me shkresën nr. 132/2 prot., datë 15.2.2023, kujtoi shoqërinë për depozitimin brenda afatit sa përcaktuar në këtë vendim.

- Me shkresën nr. 397/2 prot., datë 28.2.2023, protokolluar në ERE me nr. 1014 prot., datë 7.3.2023, shoqëria OSSH sh.a. ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit nr. 343/2022.

- Zyrtari i Pajtuëshmërisë, i miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., rezulton të jetë z. Ervis Haziri.

- Shoqëria ka depozituar në ERE dhe kontratën e nënshkruar mes ZP të përzgjedhur, z. Haziri dhe OSSH sh.a. Në pikën D të kontratës përkatëse është parashikuar që të vendoset dhe vendimi i Bordit të ERE-s me të cilin miratohet Zyrtari. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet se efektet e kësaj kontrate do të fillojnë me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s për miratimin e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë.

- Në shtojcën 1 të Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., miratuar me vendimin nr. 343/2022 janë listuar kriteret që duhet të përmbushë Zyrtari i Pajtuëshmërisë të tillë si arsimimi, eksperiencia në profesion dhe në sektorin e energjisë elektrike.

- Zyrtari i Pajtuëshmërisë z. Ervis Haziri, i propozuar nga shoqëria OSSH sh.a. i ka përmbushur kriteret e sipërcituara. Në pikat 1.2 dhe 2 të Programit të Pajtuëshmërisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë

21.12.2020, parashikohet se OSSH sh.a., përcakton, Zyrtarin e Pajtuëshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s për një mandat 3-vjeçar (trevjeçar).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e z. Ervis Haziri si Zyrtar i Pajtuëshmërisë, i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për një mandat 3-vjeçar (trevjeçar).

2. Efektet e kontratës së nënshkruar mes shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe z. Haziri fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



**VENDIM**  
**Nr. 129, datë 7.4.2023**

**MBI KËRKESËN E SHOQATËS “AREA”  
PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË  
BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË  
16.2.2023, “MBI ÇMIMIN E  
APLIKUESHËM TË BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T’U  
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES  
ME PËRPARËSI ME HYRJEN NË FUQI  
TË VKM-së NR. 67, DATË 8.2.2023”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.6.2016; neneve 67 dhe 91, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1199/2 prot., datë 5.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi kërkesën e shoqatës AREA “Për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023”, konstatoi se:

- Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), me shkresën nr. 1810/176 prot., datë 24.2.2023, ka depozituar në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 27, datë 16.2.2023 dhe me shkresën nr. 1810 prot., datë 7.3.2023, ka plotësuar kërkesën fillestare të datës 24.2.2023 duke shtuar disa argumente në mbështetje të kërkesës së paraqitur më herët.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 16, pika 5 se çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Me shkresën nr. 930/5 prot., datë 13.3.2023, është vlerësuar e nevojshme qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me sa deklaruar nga shoqata AREA gjatë periudhës së diskutimeve, si dhe në lidhje me efektet juridike të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, së sipërcituar, përpara se ERE të shprehet mbi kërkesën e AREA-s për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 27/2023, për çka rezulton se aktualisht nuk ka një përgjigje nga ana e MIE-s.

- Në rrethanat e sipërcituara, vlerësojmë se ndodhemi përpara kushteve të nenit 66 pika 1 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se: “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballlet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

- Duke qenë se shoqata “AREA” legjitimohet si palë në këtë proces dhe ka paraqitur kërkesën brenda afateve ligjore të parashikuara, vlerësohet të pranohet shqyrtimi i kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27/2023.

- Për sa i përket objektit të shqyrtimit të kërkesës, vlerësojmë se duhet marrë në konsideratë edhe qëndrimin e institucioneve të tjera si MIE të përfshira në procesin e miratimit të aktit nënligjor VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, e për këtë qëllim ERE rezervon të drejtën të shprehet përfundimisht me vendimarrje për këtë kërkesë, pasi të ketë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet që lidhen me objektin e kërkesës për rishikim.

Për sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të pranohet shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023”.

2. Të pezullojë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës





AREA, për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqatën “AREA” Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 130, datë 7.4.2023**

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK,  
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1038/4 prot., datë 5.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 203, datë 13.9.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 99, datë 20.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.3.2023 dhe 22.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitohet në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të rinovojë licencën nr. 73, seria FK08, dhënë shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 13.9.2018, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 14.9.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 131, datë 7.4.2023****MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1039/4 prot., datë 5.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 74, seria T08P, të shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.9.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 100, datë 20.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.3.2023 dhe 22.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo

dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të rinovojë licencën nr. 74, seria T08P, të shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.9.2018, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 14.9.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETAR  
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 132, datë 7.4.2023****MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) E ASËTEVE FIKSE TË CENTRALIT FOTOVOLTAIK BLUE 1 NË FAVOR TË GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A., SICAV-SIF**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, germa “b”, neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së



procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/1 prot., datë 6.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të centralit fotovoltaiik ‘Blue 1’ në favor të ‘Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, Sicav-Sif’”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135 prot., datë 27.3.2023 prot., shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, Sicav-Sif”, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë.

- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, dhe është mbajtëse e licencës nr. 507, seria P22.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin për pikën 1, gjerat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g”, “i”, “j” dhe pikën 3. Shoqëria duhet të plotësojë dhe dokumentacionin në vijim:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”.

Pika 1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.

- germa “h”: Shoqëria duhet të sqarojë/saktësojë emërtimin e llojit të aseteve të përcaktuar në aneksin 1 të Marrëveshjes së barrës siguruese, si dhe të risjellë aneksin 1 të marrëveshjes së barrës

siguruese, së bashku me vlerat konkrete të secilit aset.

- Pika 6: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse dëshiron që pjesë të dokumentacionit të depozituar nga ana e saj në kuadër të këtij aplikimi të mos jenë të hapur për publikim së bashku me arsyet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, Sicav-Sif”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 134, datë 11.4.2023

### **MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2023 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë



elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1195 prot., datë 7.4.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 2343 prot., datë 3.4.2023, protokolluar me tonën me nr. 1195 prot., datë 5.4.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a. evidentohet se shoqëria vijon të përfshijë koston e disbalancave në përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ndërkohë që ERE në mënyrë të përsëritur, me shkresën nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, ka sqaruar FSHU sh.a. se:

- Në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, e ndryshuar, tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë tek klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e lëvrimit, mbi të cilën do të

aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi.” duke kërkuar ndaj shoqërisë që të marrë në konsideratë vetëm komponentët e njohur dhe të përfshirë në formulën e përcaktuar në metodologji.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përllogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, e ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2023, përllogaritet si më poshtë:

<b>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2023</b>		
	<b>Njësia</b>	<b>Çmimi</b>
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh 16.53
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh 0.50
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh 1.55
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA</b>		<b>Leke/kWh 20.49</b>



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 20.49 lekë/kWh për muajin mars 2023.

1. Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin mars 2023, prej 20.49 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 311, datë 30.11.2022, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s" nr. 161, datë 17.6.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Vokopola Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et 'Vokopola 1', me kapacitet të instaluar 274 kw, 'Vokopola 2', me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe 'Vokopola 3', me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 22.12.2022, bëhet korrigjimi i pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi si më poshtë vijon:

1. Pika 2 e vendimit nr. 311/2022 ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria "Vokopola Energji" sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit:

a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;

c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për HEC-et "Vokopola 2" dhe "Vokopola 3".





*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8
-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 320 lekë